

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

për projektligjin:

“Për një shtesë në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar”.

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i profesionit të agronomit, si profesion i rregulluar.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

1. Përcaktimi i profesionit të agronomit si profesion i rregulluar, në kuptim të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Zgjerimi i fushës së zbatimit të ligjit në fuqi për profesionet e rregulluara, duke përfshirë edhe profesionin e agronomit në kuadrin ekzistues rregullator.
3. Vendosja e bazës ligjore për ushtrimin e profesionit të agronomit sipas kriterëve të profesioneve të rregulluara, në përputhje me parimet e interesit publik dhe mbrojtjes së cilësisë së shërbimeve profesionale.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 46/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 4.6.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 2.7.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 356 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK (4.6.2026 – 2.7.2026);

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës me përfaqësues të MBZHR.

Qëllimi i hartimit të projektligjit është zgjerimi i fushës së zbatimit të ligjit në fuqi për profesionet e rregulluara, duke përfshirë edhe profesionin e agronomit në kuadrin ekzistues rregullator.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektligjit, nuk ka patur rekomandime lidhur me draftin.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	--	---	---	-------------